



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA SHTIME
OPŠTINA ŠTIMLJE/MUNICIPALITY OF SHTIME

Komisioni Komunal për Monitorimin dhe Përkujdesjen e Fushatës së Korrje Shirjeve për vitin 2026

REFERENCË :	Ligji Nr. 08/L-072 për Bujqësi dhe Zhvillim Rural (neni 4 dhe neni 15) Ligji Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (neni 12, pika 2, shkronja (c))
DATË :	27.08.2026
PËR/ZA/TO :	Kuvendin Komunal
Cc :	
NGA/OD/FROM :	Bajram Gashi, Kryetar i Komisionit Komunal për Monitorimin dhe Përkujdesjen e Fushatës së Korrje Shirjeve për vitin 2026
TEMA /SUBJEKAT/SUBJECT	Dorëzimi i Informatës për Pikën 7 të Rendit të Ditës – Komisioni për Korrje-Shirje 2026

Të nderuar/a,

Me respektin më të madh për institucionin e Kuvendit, kisha dëshiruar që këtë raport ta prezantoja personalisht para jush, mirëpo dinamika e punëve dhe angazhimet e paracaktuara zyrtare e bëjnë të pamundur praninë time fizike në seancën e datës 01.09.2026. Megjithatë, duke vlerësuar lart rolin dhe rëndësinë e këtij Kuvendi, si dhe në përputhje të plotë me protokollin institucional dhe obligimin tim profesional, sipas ftesës tuaj, po jua përcjell përmes kësaj shkrese Informatën e plotë, të detajuar dhe përfundimtare të Komisionit Komunal për Monitorimin e Fushatës së Korrje-Shirjeve 2026 në Komunën e Shtimes, për shqyrtim në kuadër të Pikës 7 të rendit të ditës.

Në përmbyllje të procesit të monitorimit në terren, Komisioni Komunal vlerëson se fushata e korrje-shirjeve për vitin 2026 është përmbyllur me sukses të plotë dhe se ka qenë një nga sezonet më produktive të viteve të fundit. Fushata ka filluar më 30 qershor 2026 dhe është përmbyllur suksesshëm më 21 korrik 2026. Falë angazhimit maksimal të të gjithë akterëve, ky sezon shënon rezultate rekord në krahasim me vitin e kaluar, duke u karakterizuar nga një rritje e ndjeshme e rendimentit dhe një cilësi dukshëm më të lartë e drithërave në raport me vitin paraprak.

Ky sukses i dedikohet drejtpërdrejt njerëzve punëtorë të kësaj toke, punës koordinuese të komisionit dhe bashkëpunimit të shkëlqyer me fermerët, bujqit dhe pronarët e autokombanjave, të cilët kanë treguar përgjegjësi të lartë in zbatimin e masave agroteknike dhe rregullave të sigurisë. Për të garantuar një sezon me zero aksidente, kemi zhvilluar aktivitete intensive paraprake dhe gjatë fushatës.

Fillimisht kemi verifikuar gjendjen e mekanikës bujqësore për të garantuar se autokombajnave janë teknikisht të sigurta, funksionale për minimizimin e humbjeve në drithëra, si dhe kemi bërë sensibilizimin e fermerëve për zbatimin e masave të sigurisë.

Kapacitetet operuese janë përmbushur përmes angazhimit të 47 autokombanjave, procesi ka shkuar në mënyrë të rregullt dhe fushata është përmbyllur me zero incidente, zero aksidente dhe asnjë rast zjarri apo dëmtimi në terren. Nga të dhënat e grumbulluara, bilanci sipërfaqësor dhe i rendimentit paraqitet si vijon: Janë korrur me sukses gjithsej 1150 hektarë grurë, 5 hektarë elb dhe 25 hektarë tërshërë. Në parcelat ku janë zbatuar plotësisht masat agroteknike, rendimenti sillet nga 5000 deri në 6000 kg/ha, ndërsa duke marrë për bazë të gjithë territorin e Komunës së Shtimes, mesatarja e përgjithshme për hektar kap shifrat prej 4500 deri në 5000 kg/ha.

Për të garantuar që djersa e fermerëve tanë të ruhet me standardet më të larta të sigurisë për deponim, kemi kryer inspektime në dy pikat kryesore të grumbullimit të grurit në komunën tonë. Gjatë inspektimit është konstatuar se këto pika të grumbullimit plotësojnë plotësisht të gjitha kriteret teknike dhe sanitare për pranimin dhe ruajtjen e drithërave dhe garantojnë një proces transparent, të saktë dhe të sigurt për të gjithë fermerët tanë, duke siguruar që asnjë sasi e drithit të mos pësojë rënie të cilësisë gjatë fazës së deponimit.

Nga të dhënat e mbledhura në terren dhe bashkëbisedimi me fermerët, pronarët e parcelave dhe pronarët e autokombanjave, janë ngritur edhe disa shqetësime lidhur me mos përcaktimin e parakohshëm të çmimit zyrtar (orientues) të korrje-shirjeve për hektar, gjë që shkakton paqartësi financiare, vështirësi në planifikim për ekonominë familjare dhe hapësirë për spekulime në tregun lokal.

Prandaj, me qëllim që ky proces të institucionalizohet, të evitohen pakënaqësitë, të parandalohen spekulimet me çmime në treg dhe në funksion të adresimit të nevojave legjitime të bujqve tanë, Komisioni Komunal i rekomandon Drejtorisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural ndërmarrjen e këtyre dy hapave:

- 1) Të nxjerrë vendim me kohë për përcaktimin e parakohshëm të çmimit orientues të korrje-shirjeve për hektar dhe i njëjti të publikohet përpara fillimit të fushatës;
- 2) Të draftojë një Rregullore Komunale për Mënyrën e Organizimit dhe Monitorimin e Fushatës së Korrje-Shirjeve në Komunën e Shtimes. Në këtë pikë, duke qenë se ky akt normativ do të jetë shtylla e sigurisë për sezonet e ardhshme, i kërkojmë këtij Kuvendi dhe secilit anëtar mbështetje të plotë institucionale në iniciimin, hartimin dhe votimin e kësaj rregulloreje sapo ajo të procedohet për miratim. Mbështetja juaj e përbashkët për këtë rregullore është një votë e drejtpërdrejtë për mbrojtjen e djersës së fermerëve tanë dhe për një bazë të qëndrueshme ligjore që aktualisht i mungon komunës sonë.

(Statistikat operative: Grurë - Sipërfaqe e realizuar: 1150 ha; Elb - Sipërfaqe e realizuar: 5 ha; Tërshërë - Sipërfaqe e realizuar: 25 ha; Autokombanja - Kapacitetet operuese në terren: 47 copë).

Nr.	Kultura bujqësore dhe kapacitetet operuese		
1	Grurë	Sipërfaqe e realizuar e korrje-shirjeve	1150 (ha)
2	Elb	Sipërfaqe e realizuar e korrje-shirjeve	5
3	Tërshërë	Sipërfaqe e realizuar e korrje-shirjeve	25
4	Autokombanja	Kapacitetet operuese	47

Ky raport dëshmon se kur institucionet, Kuvendi dhe fermerët koordinohen mirë, sukcesi është i garantuar. Mbetemi në dispozicionin tuaj për çfarëdo sqarimi apo diskutimi shtesë lidhur me gjetjet e këtij raporti si dhe jemi plotësisht të gatshëm për të bashkëpunuar ngushtë me ju në hartimin dhe finalizimin e këtyre akteve normative.

Kërkoj nga Kryesuesi i Kuvendit që këtë shkresë t'ua prezantojë të pranishmëve gjatë shqyrtimit të Pikës 7 të rendit të ditës.

Ju faleminderit për mirëkuptimin dhe bashkëpunimin!

Me respekt,